

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEHNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njësta Org. 6
Org. Jedinica 6
Org Unit 6
Nr. I faqeve 2
Br. stranic 2
No. pages 2

Nr. Prot: 3463
Broj Prot: 3463
Prot. No: 3463
Data: 27/09/2019
Datum: 27/09/2019
Date: 27/09/2019

Prishtinë, 16.09.2019



RIT Kosovo (A.U.K.) College
DATE: 27.09.2019
PROTOCOL NUMBER: I/15.1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education Science & Technology

Datë: 27.09.2019
Nr. 2-3463

Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të dispozitave të nenit 11 paragrafi 3 dhe 4, nenit 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 si dhe në bazë të neneve 5,6,7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, në bazë të kërkesës për rilicencim nga BPrAL- Kolegji Rit Kosovo (A.U.K) nr. 3463 të datës 16.09.2019, nxjerr:

V E N D I M

1. Licencohet Bartësi Privat i Arsimit të Lartë (BPrAL) – Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) në Prishtinë.
2. Kohëzgjatja e licencës së kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.) është për tri (3) vite akademike prej dt.01.10.2019 deri më dt.30.09.2022.
3. BPrAL – Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) licencohet në bazë të akreditimit institucional dhe për programet e akredituara/riakredituara nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.
4. Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) obligohet t’u përmbahet kushteve dhe kriterëve në bazë të vendimeve të akreditimit dhe numrit të lejuar të studentëve.
5. Inspektorati i Arsimit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, monitoron zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsy e t i m

Në mbështetje të dispozitave të cekura më lartë, bazuar në kërkesën e Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) me nr. prot. 3463 dt. 16.09.2019, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për licencim të BPrAL i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i ka udhëhequr procedurat e nevojshme administrative dhe procedurale me qëllim të vlerësimit të këtij BPrAL.

Parashtruesi i kërkesës ka paraqitur dokumentacionin e kompletuar sipas kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

Komisioni ka vlerësuar se Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) i ka plotësuar kushtet dhe kriteret e parapara me legjislacionin në fuqi për licencim, ka programe të akredituara/riakredituara dhe akreditim institucional sipas vendimit me nr. 1371/19D dt. 29.07.2019 të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim. Afati për akreditimin institucional është nga dt. 1 tetor 2019 deri me dt. 30 shtator 2022, prandaj komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, Sekretarit të përgjithshëm të MASHT-it.

Vendimi u dërgohet:

1. Arkivit të MASHT-it;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Komisionit për licencim;
4. Sekretarit të përgjithshëm, MASHT;
5. DALSHT;
6. DNJBIA;
7. Inspektoratit të Arsimit, MASHT.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

